

Dervish ALIM

GJUHA STANDARDE, LETRARE DHE ZYRTARE, KUR DHE SI?

A. 1. Gjuha standarde dhe jostandarde

Një gjuhë standarde përcaktohet ose si një varietet gjuhësor, i përdorur nga një popullatë për komunikime publike, ose si shumëllojshmëri e gjuhës që ka pësuar kodifikimin e gramatikës dhe përdorimit.

Një gjuhë standarde është një gjuhë e larmishme që përdoret nga qeveritë, në media, në shkolla dhe për komunikim ndërkombëtar. Ekzistojnë lloje të ndryshme të anglishtes standarde në botë, siç janë anglishtja e Amerikës së Veriut, anglishtja australiane dhe ajo angleze indiane. Megjithatë këto varietete të standardeve ndryshojnë për sa i përket shqiptimit të tyre, midis tyre ekzistojnë pak dallime në gramatikë. Anasjelltas, ekzistojnë forma jostandarde të një gjuhe që përdoren, për shembull, në dialekte të ndryshme rajonale dhe këto varietete jostandarde janë të ndryshme nga njëra-tjetra.

Sipas lingvistit të njohur Richard Hudson¹, një gjuhë standarde është "një varietet që në mënyra të ndryshme njihet si më korrekte dhe më e pranueshme sesa varietetet tjera. Në shumë mënyra, shumëllojshmëria standarde është një përcaktim po aq i përshtatshëm". Hudson thekson se "në përgjithësi, vetëm gjuhët standarde kanë një formë të qëndrueshme të shkruar, që është ajo që mësohet në shkolla të përgjithshme dhe që ndodhet edhe në fjalor dhe në kontekste profesionale dhe formale".

I ain't going to school today. (standard form: *I'm not going to school today.*)

She don't understand. (standard form: *She doesn't understand.*)

Would you like a cheese cob? (*cob* is a dialect word in parts of the north of England and means 'bread roll'.)

Dialektet standarde nuk janë më të mira se dialektet tjera, por ne nuk përdorim fjalë apo gramatikë dialektesh në një ese, gjatë një interviste ose në kontekste të tjera zyrtare.

2. Kompetenca gjuhësore

Sipas akademikut Shaban Sinani, kompetenca gjuhësore nuk është thjesht një nevojë për t'u shprehur, por edhe një standard formimi. "Unë mendoj se problemi është më i thellë. Është problem i kulturës së përgjithshme të këtyre njerëzve, që aq të cunguar sa janë në përdorimin e gjuhës shqipe, aq të kufizuar janë edhe në formimin e tyre kulturor. Gjuha thjesht dekonspiron mungesën e kulturës. Dëshpërimi është ky, që gjuha e tyre dekonspiron mungesën e thellë katastrofale të kulturës së përgjithshme".

Gjuha shqipe mund të konsiderohet si një gjuhë që i mungon higjiena gjuhësore. I mungojnë rojtarët gjuhësorë, i mungon editoria, i mungojnë të gjitha ato kushtëzime që e bëjnë të detyrueshëm përdorimin e njesuar të saj. Që nga Kongresi i Drejtshkrimit, i cili mori një vendim të arsyeshëm dhe të drejtë, deri më sot nuk ka pasur akte zyrtare, që të konfirmojnë mënyrën se si funksionon shqipja në një shoqëri të hapur.

Në gjuhën shqipe kemi edhe disa paqartësi drejtshkrimore, sepse jo të gjitha rregullat janë përfshirë në mënyrë unike nëpër librat e gramatikës së gjuhës shqipe, sidomos të destinuara për të huaj që do të kishin shprehur interesim ta mësonin gjuhën shqipe. Shqetësimi më i madh i lexuesit dhe folësit të gjuhës shqipe konsiston në përdorimin e shkronjës "ë" në gjuhën e shkruar, e cila në gjuhën shqipe ka një përdorim të gjerë dhe ekzistenca e saj në fund të fjalës është kryesisht me qëllim të theksimit të zanores së gjatë (i) në rrokjen paraprake, p.sh. shtëpinë, matematikë, etj.

Edhe gjatë përdorimit të saj në fjalët e përbëra, si p.sh. bashkëpun(ë)tor, bashk(ë)udhëtar, duhet pasur rregulla të përgjithshme dhe koncize të përdorimit të saj për të gjitha rastet e njëjta dhe të ngjashme. Për shembull, në rastin e parë e kemi ruajtur zanoren "ë" te fjala bashkë, e pasuar nga fjala punëtor, sepse pason bashkëtingëllorja në pjesën e dytë, por nuk e kemi ruajtur domosdoshmërisht kur pas saj vjen edhe një zanore tjetër; pastaj te fjalët punë+tor dhe udhë+tar, po ashtu kemi fjalëformim me prapashitesa dhe këtu qëllimi është të ruhet kuptimi i fjalës fillestare, e cila do të rrezikonte zbehjen në rast të mungesës së saj.

Edhe gjatë lakimit të emrave dhe përemrave mungojnë rregulla strikte të përdorimit sipas rasave përkatëse për alternimin e përemrit lidhor "së/të cilës". Këtu të huajt që e studiojnë gjuhën shqipe kanë mungesë të rregullave standarde për rastin përse në gjininë femërore kemi dy variacione të përdorimit të nyjes "së-të". Pra, ata duhet ta dinë qartë se ky alternim ndodh vetëm në rasën gjinore (së), por jo edhe në rasat tjera, si dhanore (të) cilës, kallëzore (të) cilën, por edhe rrjedhore prej të cilës, për/më të cilën, etj.

Ortografia dhe semantika shqiptare nuk e kanë thënë ende fjalën e fundit për domosdoshmërinë e përshtatjes fonetike të fjalëve të huazuara, me një rregull që do vlente për të gjitha rastet e njëjta apo të ngjashme, që doemos të jetë shumë e afërt me mënyrën e shqiptimit të fjalës së huazuar apo shqipërimit të saj në gjuhën shqipe. Për shembull: Ku është dallimi fonetik tek fjalët e huazuara: ekzistoj dhe ekzekutoj, nga fjalët egzaminuj, egzageroj, e të ngjashme?! Përse këtu na duhet shkruar germa "k", kur e shqiptojmë germën "g". Vetëm për shkak të praktikës apo shprehisë së deritashme, apo duhet pasur argumente të qëndrueshme shkencore?!

B. Gjuha letrare

Gjuha letrare, nga pikëpamja sociolinguistike frënge, është një nga llojet e gjuhës. Dallimet kanë të bëjnë me përkufizimin e saj, për përcaktimin e llojeve të tjera të gjuhës, si dhe me rolin që i atribuohet në letërsi, kulturë, arsim dhe shoqëri.

1. Gjuha letrare si gjuhë standarde

Normalisht, standardizimi i një gjuhe filloi me atë të larmisë së tij letrare dhe, në kohën e këtij standardizimi, rregullat e gjuhës letrare u vendosën si të vlefshme për gjuhën në përgjithësi, duke e ngatërruar kështu gjuhën letrare terminologjikisht me atë që quhet "gjuhë standarde". Ky konceptim është përjetësuar deri relativisht kohët e fundit.

Megjithatë, sa i përket gjuhës letrare, Edlira Mantho (2009), p.sh. konsideron se nocioni i gjuhës letrare është më i gjerë se ai i gjuhës standarde, duke përfshirë këtu dhe në të njëjtën kohë gjuhën e letërsisë artistike, e cila mund të jetë dialektore. Kjo ide lidhet me situatën e gjuhës kombëtare shqiptare e cila bazohet në gjuhën e letërsisë në dialektin toskë, të folur në Shqipërinë e Jugut, dominues në kohën e zgjimit të vetëdijes kombëtare.

Norma letrare toske u vendos si një standard i vetëm për të gjithë vendin, si edhe për shqiptarët e Kosovës me rrethinë, edhe pse derisa u vendos regjimi komunist, vazhdoi të ekzistonte paralelisht edhe një letërsi në dialektin gegë, e folur në Shqipërinë Veriore dhe në Kosovë. Kjo letërsi ishte edhe e ndaluar nën regjimin komunist, por ajo u rigjallërua pas rënies së këtij të fundit.

Në kohën e sotme në Kosovë fatkeqësisht konfrontohen dy ide me njëra-tjetrën: ajo e braktisjes së standardit të bazuar në toskërishte dhe e ruajtjes së tij për të gjithë shqiptarët. Sipas Shkelqim Millakut², përdorimi i gjuhës standarde shqipe në Kosovë falë (mos)respektimit të gjuhës standarde shqipe në Republikën e Kosovës është i dyanshëm. Në rrafshin e parë sipas tij, kemi të bëjmë me një përpjekje të një elite të heshtur, e cila me fanatizëm e ruan dhe zhvillon gjuhën standarde. Në këtë rrafsh duhet vlerësuar kujdesi i shtuar i administratës, i mediave, mbishkrimet e rrugëve, shkrimet dhe publikimet e ndryshme në faqet zyrtare të institucioneve publike dhe private, në institucionet qendrore dhe komunale; në procedura gjyqësore; në arsim; emrat personal, etj. Kurse, në rrafshin e dytë në disa qendra shqiptare kemi grupe individësh që kanë koncepte të ndryshme për mosrespektimin e shqipes standarde. Andaj, edhe kjo rrymë mund të shihet në administratë, në media (gazeta, TV, ...), në mbishkrimet e rrugëve, shkrimet dhe publikimet e ndryshme në faqet zyrtare të institucioneve publike dhe private etj.

Nga sa u përmend më lart mund të konkludojmë se nocioni gjuhë standarde dhe letrare nuk janë sinonime, që do të thotë se janë të ngjashme por jo edhe të njëjta. Shikuar historikisht, gjuha letrare është pararendëse e nocionit gjuhe standarde, sepse fillimisht gjuha letrare ka qenë koncepti gjuha e shkruar, d.m.th. gjuha e letërsisë, që detyrimisht më vonë është dashur t'u përmbahet rregullave të caktuara të drejtshkrimit, dhe gramatikore, dhe si e tillë i ka respektuar

standardet dhe normat gjuhësore, të kodifikuara, apo të unifikuara në Konferencën e Drejtshkrimit të v. 1971. Prandaj gjuha letrare dhe kultura gjuhësore apo e leximit ka qenë burim parësor dhe baza kryesore e referencës gjatë përpilimit të një teksti të shkruar akademik.

Por, me kalimin e kohës, koncepti gjuha letrare apo gjuha e letërsisë e ka humbur primatin e udhërrëfyesit të gjuhës së shkruar, pasi falë stileve të ndryshme letrare dhe përdorimit të vokabularit burimor të dy dialekteve kryesore dhe nëndialekteve të shumta, ku krijues të ndryshëm me talent për të shkruar por jo edhe me njohuri të thella të normave dhe rregullave gjuhësore, sidomos në rajonet veriore ku mbisundon dialekti i gegërishtes, si dhe falë zgjerimit të diapazonit dhe fushëveprimit të gërshetimit gjuhësor të shkencave gjuhësore, por dhe më qëllim që të pasqyrohet sa më burimisht nevoja e gjetjes së një emërtimi të ri që e përkufizon gjuhën e shkruar si një gjuhë që në vete ngërthen norma të sakta të përdorimit me rregulla precize ortografike dhe gramatikore morfologjiko-sintaksore, nocioni "gjuhë standarde" nga dita më ditë e zëvendëson dhe prevalon nga dita më ditë nocionin "gjuhë letrare".

Shikuar globalisht, gjuhët moderne botërore si gjuha frënge dhe angleze, por edhe gjermane, në aspektin fonetik dhe ortografik gjegjësisht të shqiptimit dhe të drejtshkrimit, kanë devijuar dukshëm nga versioni fillestar i krijimit të gjuhës së shkruar, të përputhjes fonetike dhe ortografike të shqiptimit të fjalëve sipas parimit "një fjalë=një shkronjë". Kjo ka ndodhur për shkak se gjuha e folur është një organizëm i gjallë që ndryshon me kalimin e një kohe më të gjatë, të cilën gjuha e shkruar nuk ka mundur ta ndiqte hap pas hapi.

Një arsye tjetër e pamundësisë së ndryshimit rrënjësor të gjuhës së shkruar në përputhje me gjuhën e folur tashmë të ndryshuar dukshëm, është edhe rreziku i shpëputjes historike të mbamendjes kombëtare, në kuptimin se në rast të tillë, generatat e reja do ta kishin të pamundur ta kuptonin gjuhën e shkruar, tashmë "të vjetër" të shekujve të mëparshëm.

Pikërisht krijimi i gjuhës standarde ka shërbyer si pika e vazhdimësisë së mbamendjes kolektive të një kombi, e cila tashmë është edhe bilinguale, për vetë faktin se një person flet edhe gjuhën dialektore në shtëpi, edhe gjuhën standarde në shkolla dhe institucione.

C. Gjuha zyrtare

Një gjuhë zyrtare, e quajtur edhe "gjuhë shtetërore", është një gjuhë që i jepet një status juridik i veçantë në një vend, shtet ose juridiksion tjetër, e pranuar dhe njohur me ligj të posaçëm apo me Kushtetutën e vendit apo shtetit. Prandaj, gjuha zyrtare e një vendi i referohet gjuhës së përdorur në qeveri (gjyqësor, legjislativë, administratë). Pra, shprehja "gjuhë zyrtare" nuk i referohet zakonisht gjuhës së përdorur nga një popull ose vend, por nga qeveria e tij, pasi që nga ana tjetër "mënyra e shprehjes së një populli nuk mund të caktohet dhe ndryshohet me asnjë ligj".

1. Gjuhët zyrtare në botë

Në rrafshin botëror, rreth gjysma e vendeve të botës kanë të shpallur-a një ose më shumë gjuhë zyrtare. Disa qeveri, si p.sh. ajo e Italisë e zyrtarizoi italishten shumë vonë, pra vetëm në v. 1999, dhe nga ana tjetër disa kombe (siç janë Shtetet e Bashkuara) nuk kanë shpallur kurrë ndonjë gjuhë zyrtare në nivel kombëtar. Kombet tjera kanë shpallur për gjuhë zyrtare gjuhët joindigjene. P.sh. "Filipinet dhe pjesët e Afrikës jetojnë me një paradoks kulturor të veçantë. Megjithëse gjuhët zyrtare në Afrikë janë frëngjishtja ose anglishtja, këto nuk janë gjuhët që fliten më gjerësisht nga banorët e vendit.

Në të gjithë botën, 178 vende kanë të paktën një gjuhë zyrtare dhe 101 prej këtyre vendeve njohin më shumë se një gjuhë. Shumë nga kushtetutat e botës përmendin një ose më shumë gjuhë zyrtare ose kombëtare.

Disa vende përdorin përcaktimin e gjuhës zyrtare për të fuqizuar grupet indigjene duke u dhënë atyre mundësinë e shfrytëzimit të shërbimeve të qeverisë në gjuhët e tyre amtare.

Në vendet që nuk përcaktojnë zyrtarisht një gjuhë zyrtare, zakonisht zhvillohet një gjuhë de facto kombëtare. Anglishtja është gjuha zyrtare më e zakonshme, me status të njohur në 51 vende. Arabishtja, frëngjishtja dhe spanjishtja njihen gjithashtu gjerësisht.

Një gjuhë zyrtare që është edhe gjuhë indigjene quhet endoglosike, ndërsa një gjuhë që nuk është indigjene quhet ekzoglosike. Një shembull i tillë është Nigeria që ka tre gjuhë zyrtare endoglosike. Me këtë, vendi synon të mbrojë gjuhët indigjene edhe pse në të njëjtën kohë e njëj gjuhën angleze si lingua franca të saj.

2. Gjuhët zyrtare në BE

Zgjedhja e një gjuhe zyrtare (ose asnjë gjuhë zyrtare) është shpesh e diskutueshme. Alternativa e të pasurit një gjuhë të vetme zyrtare është "shumëgjuhësia zyrtare", ku një qeveri njeh gjuhë të shumta zyrtare. **Sipas këtij sistemi, të gjitha shërbimet qeveritare janë në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare. Secili qytetar mund të zgjedhë gjuhën e tij të preferuar kur bën biznes.** Shumica e vendeve janë shumëgjuhëshe dhe shumë gjuhë janë zyrtare. Shembuj të shumëgjuhësisë zyrtare janë Tajvani, Kanada, Filipinet, Belgjika, Zvicra dhe Bashkimi Evropian.

3. Gjuhët rajonale, gjysmë zyrtare dhe të pakicave kombëtare

Disa gjuhë rajonale ose të pakicave që fliten brenda BE-së nuk kanë njohje zyrtare në nivelin e BE-së. Disa prej tyre mund të kenë një status zyrtar brenda shtetit anëtar dhe numërojnë shumë më tepër folës se disa nga gjuhët zyrtare më pak të përdorura. Gjuhët zyrtare të BE-së janë të theksuara.

Pesë gjuhë rajonale evropiane gëzojnë statusin e një gjuhe **gjysmë zyrtare** (ose të një gjuhe bashkëzyrtare), që do të thotë se ato mund të përdoren zyrtarisht nën një marrëveshje administrative ndërmjet Këshillit dhe Shtetit Anëtar kërkuar. Këto janë: skotishtja, galishtja dhe vellsishtja, të njohura në Mbretërinë e Bashkuar; dhe gjuha galike, katalonase dhe baske, të cilat dy të fundit, **janë gjuhë bashkëzyrtare** në Spanjë, së bashku me, ndër të tjera, korsishten, oksitanishten dhe bretonishten, që janë **gjuhët rajonale** në Francë por që nuk gëzojnë status zyrtar atje.

4. Gjuhët zyrtare në Maqedoninë e Veriut

Nuk është rastësi që elementi kryesor i definimit të një gjuhe zyrtare është fakti se sipas këtij sistemi, të gjitha shërbimet qeveritare janë në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare dhe secili qytetar mund të zgjedhë gjuhën e vet të preferuar kur bën biznes.

Nëse nuk përmbushen këto dy kritere gjuha shqipe mund të konsiderohet vetëm si gjuhë **rajonale dhe gjysmë zyrtare**, për faktin se përdorimi i gjuhës shqipe është i kushtëzuar të shkojë në çift, krahas me gjuhën maqedonase si gjuhë e domosdoshme shoqëruese, si gjuhë e popullatës dominante të vendit. Për këto arsye, zyrtariteti i gjuhës së popullatës së dytë për nga përqindja në vend **është i cunguar dhe i pjesshëm**, edhe pse ajo është e lejuar në nivel lokal dhe në kontakte individuale me organet qendrore, por jo në tërë territorin e vendit dhe aspak në nivel ndërkombëtar.

5. Gjuha e mësimdhënies dhe gjuha zyrtare

Gjuha e mësimdhënies nuk është detyruesisht edhe zyrtare, por mund të jetë në përdorim zyrtar, si gjuhë rajonale apo lokale. Si e tillë, Në Maqedoninë e Veriut, gjuha shqipe ka qenë me dekada në përdorim zyrtar për përdorim të brendshëm pedagogjik, në vendbanime me shumicë të konsiderueshme të folësve të gjuhës tjetër, që nuk është zyrtare në një shtet të quajtur unitar.

Kjo nënkupton se bartësi i sovranitetit ia ka dhënë lejen dhe të drejtën një bashkësie etnike ta përdori gjuhën e saj për përdorim lokal dhe të brendshëm, por jo edhe në komunikim zyrtar me organet qendrore. Kështu, nëpër shkolla me mësimdhënie në gjuhën shqipe ka dy variante të përdorimit të gjuhës shqipe, edhe atë: **për evidencë pedagogjike** të mësimdhënies, (por jo) edhe **në dokumentacionin zyrtar**, ku gjuha shqipe detyruesisht duhet të shoqërohet edhe me gjuhën maqedonase.

Një diferencim i tillë i gjuhës së mësimdhënies dhe i gjuhës zyrtare nënkupton se nxënësi dhe pedagogët shqiptarë janë të lejuar për shkaqe praktike të zhvillimit të mësimin, të shkruajnë dhe komunikojnë në gjuhën e tyre amtare, por jo edhe në komunikim zyrtar, pa e shoqëruar atë me gjuhën maqedonase me status të plotë zyrtar.

Edhe ky fakt e dëshmon inferioritetin dhe gjysmëzyrtaritetin e statusit të gjuhës shqipe, e cila gjen përdorim të pjesshëm në institucionet publike dhe shtetërore, gjë që shkakton ngarkesa të panevojshme administrative për qytetarët dhe mësimdhënësit shqiptarë, të cilët duhet të harxhojnë kohë plotësuese dhe të bëjnë punë të dyfishtë për përpilimin e dokumentacionit zyrtar.

6. Gjuha e 20 % (përqindëshit)

Edhe me ndryshimet e reja ligjore, përveç zgjerimit të fushave të përdorimit institucional të gjuhës në rrafshin lokal dhe qendror, sërish ekziston domosdoshmëria praktike e evidencës dhe korrespondencës së dyfishtë zyrtare, që edhe një herë dëshmon se gjuha maqedonase ka status të plotë zyrtar, si e vetme në tërë territorin shtetëror dhe në komunikimin ndërkombëtar, ndërsa gjuha shqipe e 20% ka status gjysmëzyrtar, sepse nuk përdoret si e vetme por në çift dhe jo në tërë territorin, dhe aspak në komunikim ndërkombëtar.

Kjo edhe fizikisht e dëshmon hapësirën e kufizuar të përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe, kështu që barazimi i saj i plotë ligjor në nivel shteti do të bëhej sikur të mos ishte e detyrueshme të shoqërohej me gjuhën maqedonase dhe sikur të ishte e lejuar të përdorej si e vetme në nivel të gjithë vendit, si dhe jashtë vendit në komunikimin zyrtar të perfaqësive diplomatike shtetërore.

Fundja, edhe çështja e rregullimit politik dhe kushtetues i një shteti është në korrelacion të plotë me çështjen e statusit zyrtar të një gjuhe brenda këtij shteti. Një shtet unitar e ka vetëm një gjuhë zyrtare në gjithë vendin, ndërsa gjuhët tjera shërbejnë si gjuhë rajonale apo të pakicave, pra kanë status gjysmëzyrtar në rajone dhe fusha të caktuara të përdorimit.

Bibliografia

"Hudson, Prof. Richard Anthony", Ëho's Ëho (online edition, Oxford University Press, December 2017). Retrieved 19 June 2018.

<http://revistahaemus.blogspot.com/2016/04/edlira-mantho-standard-albanian.html>

https://www.academia.edu/6051262/Shk%C3%ABlqim_Millaku_-Studime_gjuh%C3...

Rexhep Ismajli: "Beyond the infinitive alternative or minority status" in *"Philological studies"*, nr. 8, 9, 2001 – 2002, Prishtinë, p. 56.

Rami Memushaj: "Standard language, a national and not a totalitarian creature" in *"Gjuha shqipe"*, nr. 3, 2013, Prishtinë, p. 26 and also in the neëspaper *"Shekulli"*, 20.11.2010, Tiranë.

Shefki Sejdiu: "Something else about (the Albanian) language, (equalised) language and national (standard) language", in *"Kultura e gjuhes"*, publication of The Association of the Albanian Language of Kosovo, nr. 2, Prishtinë, 2013, p. 56.

From the speech of Eqrem Çabej: "Against the pseudophilologists", held in Graz, 8.11. 1929. See: Shaban Demiraj: *"Eqrem Çabej"*, Tiranë, 2008, p. 251.